

## Statistikat e krimeve dhe drejtësisë penale, 2021

**Tiranë, më 5 Maj 2022:** Në këtë publikim, statistikat e krimeve japin informacion mbi veprat penale, autorë të veprave penale, persona të dëmtuar, procedime penale, persona të pandehur dhe të dhëna mbi të burgosurit.

### Vepra penale


Në vitin 2021, janë evidentuar gjithsej 35.175 vepra penale, 7,5 % më shumë, krahasuar me vitin 2020. Në raport me popullsinë në vitin 2021, janë evidentuar 125,1 vepra penale për 10 mijë banorë, nga 115,4 që ishin në vitin 2020.

**Tab. 1 Vepra penale të evidentuara**

Vepra penale	2017	2018	2019	2020	2021
Vrasje me dashje	50	51	58	52	61
Vrasje të mbetura në tentativë	129	114	93	114	101
Krime me dashje kundër shëndetit	2.650	2.493	2.449	2.521	2.176
Krime seksuale	113	110	155	146	136
Vjedhje (neni 134)	4.351	4.532	4.290	3.909	3.508
Vjedhje me dhunë	169	108	85	88	85
Vjedhje me armë	13	22	13	14	11
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	118	70	76	46	67
Mashtrime	1.127	1.040	959	876	975
Fallsifikim monedhash	85	82	84	86	67
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.412	1.374	1.341	1.505	1.631
Krime në fushën e drogës	2.070	1.907	1.989	2.086	3.078
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	5.316	5.713	5.652	5.300	5.854
Tjetër	16.714	16.852	17.966	15.993	17.425
<b>Gjithsej</b>	<b>34.317</b>	<b>34.468</b>	<b>35.210</b>	<b>32.736</b>	<b>35.175</b>
<b>Për 10 mijë banorë</b>	<b>119.4</b>	<b>120.2</b>	<b>123.4</b>	<b>115.4</b>	<b>125.1</b>

Veprat penale Dhunë në familje, Krime në fushën e drogës, Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, Vrasje me dashje, Mashtrime dhe Vjedhje duke shpërdoruar detyrën janë rritur, krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa pjesa tjetër e veprave penale ka pësuar rënie.

**Fig. 1 Ndryshimi në përqindje i veprave penale, 2020-2021**



**Autorë të veprave penale**


Në vitin 2021, janë regjistruar 39.328 autorë për vepër penale, 4,0 % më pak, krahasuar me vitin 2020. Numri i autorëve sipas veprave penale përfshin numrin e personave të dyshuar të cilët mund të jenë të pranishëm në më shumë se një vepër penale dhe autori numërohet në të gjitha veprat ku është i dyshuar. Ndërkohë, numri i autorëve pa përsëritje në veprat penale, në vitin 2021 është 35.745 autorë, 1,5 % më shumë, krahasuar me vitin 2020.

**Tab. 2 Autorë për vepër penale**

Vepra penale	2017	2018	2019	2020	2021
Vrasje me dashje	48	60	78	70	67
Vrasje të mbetura në tentativë	156	149	113	139	150
Krime me dashje kundër shëndetit	3.487	3.264	3.279	3.342	2.964
Krime seksuale	111	114	162	165	142
Vjedhje( neni 134)	2.909	3.178	2.608	3.019	2.685
Vjedhje me dhunë	157	115	101	94	113
Vjedhje me armë	381	23	34	35	17
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	130	77	104	54	89
Mashtrime	1.141	1.033	983	954	1.088
Fallsifikim monedhash	81	77	69	69	98
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.507	1.459	1.438	1.604	1.733
Krime në fushën e drogës	2.482	2.357	2.703	3.202	3.793
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	5.173	5.530	5.473	5.128	5.672
Tjetër	18.288	22.213	25.900	23.081	20.717
<b>Autorë Gjithsej</b>	<b>36.051</b>	<b>39.649</b>	<b>43.045</b>	<b>40.956</b>	<b>39.328</b>
<b>Autorë pa përsëritje të veprave penale</b>	<b>32.289</b>	<b>34.537</b>	<b>36.083</b>	<b>35.213</b>	<b>35.745</b>


Meshkujt përbëjnë 93,8 % të totalit të autorëve të veprave penale.

**Fig. 2 Autorë gjithsej dhe autorë meshkuj për vepër penale**



Në vitin 2021, 33,8 % e autorëve janë të grup-moshës 30-44 vjeç, 28,1 % të grup-moshës 18-29 vjeç dhe 22,1 % i përkasin grup-moshës 45-59 vjeç. Edhe në raport me popullsinë, renditja e autorëve sipas grup-moshave është e njëjtë

**Fig. 3 Autorë për vepër penale sipas grup-moshës, 2021**



**Të dëmtuar**


Në vitin 2021, janë regjistruar 16.910 persona të dëmtuar, 5,2 % më pak, krahasuar me vitin 2020. Personat e dëmtuar për krime kundër personit përbëjnë 37,9 % të totalit të personave të dëmtuar.

**Tab. 3 Të dëmtuar**

Të dëmtuar	2017	2018	2019	2020	2021
Krime kundër jetës	1.606	1.652	1.416	1.466	1.303
Krime kundër shëndetit	3.239	2.982	2.986	3.072	2.616
Krime seksuale	114	105	148	132	129
Vepra penale kundër lirisë së personit	146	173	181	143	120
Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit	350	335	321	305	313
Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes	1.777	1.736	1.652	1.772	1.881
Të tjera kundër personit	25	24	40	38	49
<b>Të dëmtuar për krime kundër personit</b>	<b>7.257</b>	<b>7.007</b>	<b>6.744</b>	<b>6.928</b>	<b>6.411</b>
<b>Të dëmtuar gjithsej</b>	<b>19.062</b>	<b>19.101</b>	<b>18.858</b>	<b>17.829</b>	<b>16.910</b>

Në vitin 2021, në totalin e personave të dëmtuar për krime kundër personit, femrat përbëjnë 27,8 % të të dëmtuarve dhe përqindja më e madhe e tyre vihet re në krime seksuale, krime kundër moralit dhe dinjitetit si edhe krime kundër fëmijëve, martesës dhe familjes.

**Fig. 4 Të dëmtuar për krime kundër personit sipas gjinisë, 2021**




**Procedime penale**

Në vitin 2021, numri i procedimeve penale të regjistruara është 28.349 procedime, 1,8 % më shumë, krahasuar me vitin 2020. Nga 25.688 procedime penale të përfunduara, 23,3 % e tyre janë pushuar, 34,7 % janë pezulluar dhe 42 % janë dërguar për gjykim në gjykatë.

**Tab. 4 Procedime penale të regjistruara**

Vepra penale	2017	2018	2019	2020	2021
Vrasje me dashje	120	126	137	128	117
Vrasje të mbetura në tentativë	43	52	28	35	48
Krime me dashje kundër shëndetit	862	908	903	861	823
Krime seksuale	102	113	158	136	158
Vjedhje (neni 134)	9.514	9.219	8.682	7.812	7.010
Vjedhja me dhunë	187	118	117	123	112
Vjedhja me armë	22	35	15	15	11
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	127	114	85	68	78
Mashtrime	1.060	872	745	627	752
Fallsifikim monedhash	78	80	82	75	62
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.310	1.209	1.140	1.251	1.406
Krime në fushën e drogës	1.764	1.524	1.548	1.793	2.069
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	3.639	4.121	4.038	3.911	4.374
Tjetër	12.634	12.898	13.017	11.017	11.329
<b>Gjithsej</b>	<b>31.462</b>	<b>31.389</b>	<b>30.695</b>	<b>27.852</b>	<b>28.349</b>

**Fig. 5 Progresi i procedimeve penale të përfunduara**




### Të pandehur

Në vitin 2021, janë regjistruar 16.196 persona të pandehur, 20,8 % më shumë, krahasuar me vitin 2020. Meshkujt përbëjnë 94,9 % në totalin e personave të pandehur.

**Tab. 5 Të pandehur për vepra penale**

Vepra penale	2017	2018	2019	2020	2021
Vrasje me dashje	98	111	132	110	87
Vrasje të mbetura në tentativë	33	38	32	28	59
Krime me dashje kundër shëndetit	698	622	542	508	614
Krime seksuale	79	66	111	101	128
Vjedhje (neni 134)	1.376	1.299	1.078	979	1.102
Vjedhja me dhunë	87	73	70	73	85
Vjedhja me armë	17	13	18	14	9
Vjedhje duke shpërdoruar detyrën	78	68	86	42	68
Mashtrime	827	446	384	328	328
Fallsifikim monedhash	41	45	38	22	34
Dhuna në familje (neni 130/a)	1.194	1.198	1.038	1.081	1.304
Krime në fushën e drogës	1.819	1.183	921	1.033	1.487
Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor	3.034	3.596	3.152	3.213	3.689
Tjetër	6.975	7.491	7.119	5.877	7.202
<b>Gjithsej</b>	<b>16.356</b>	<b>16.249</b>	<b>14.721</b>	<b>13.409</b>	<b>16.196</b>

**Fig. 6 Persona të pandehur sipas gjinisë**



### Të burgosur


Në vitin 2021, numri i të burgosurve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale është 4.956, 7,4 % më shumë, krahasuar me vitin 2020. Në raport me popullsinë, në 2021 janë 18 të burgosur për 10 mijë banorë, nga 16 të burgosur që ishin një vit më parë. Meshkujt përbëjnë 98,7 % të totalit të të burgosurve.

**Tab. 6 Të burgosur sipas veprave penale**

Vepra penale	2017	2018	2019	2020	2021
Vjedhje	1.049	859	811	713	684
Vrasje	994	1.053	1.006	1.012	895
Plagosje	103	94	74	80	95
Krime seksuale	90	108	117	112	45
Krime në fushën e drogës	1.598	1.706	1.580	1.311	1.431
Organizata kriminale	26	52	78	71	70
Mashtrim	99	112	129	121	127
Shfrytëzim prostitucioni	90	78	67	51	44
Të tjera	1.369	1.254	1.183	1.143	1.565
<b>Gjithsej</b>	<b>5.418</b>	<b>5.316</b>	<b>5.045</b>	<b>4.614</b>	<b>4.956</b>

Grup-mosha 21-29 vjeç ka normën më të lartë të të burgosurve në raport me popullsinë. Personat mbi 60 vjeç dhe nën 20 vjeç kanë normën më të ulët të të burgosurve.

**Fig.7 Të burgosur për 10 mijë banorë sipas grupmoshës**



# Metodologjia

*Burimi i të dhënave:* Të dhënat janë siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Të dhënat mbi statistikën e krimeve dhe drejtësisë penale janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.

## 1. Vepra penale

Statistikat mbi veprat penale të evidentuara japin një pamje gjithëpërfshirëse të të gjithë rasteve të raportuara në polici. Ato tregojnë numrin e veprave penale që janë raportuar dhe evidentuar si vepra penale nga policia.

## 2. Autorë

Të dhënat mbi autorët bazohen në persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale. Totali i autorëve paraqet numrin e autorëve për vepër penale. Një autorë mund të jetë i pranishëm në më shumë se një vepër penale.

## 3. Persona të dëmtuar

Të dëmtuarit/viktimat e veprave penale i referohen personave të dëmtuar nga kryerja e një vepre penale gjatë një viti.

## 4. Procedime penale

Statistikat mbi procedimet penale paraqesin të dhëna për procedimet penale të regjistruara, pushuara, pezulluara dhe procedimet penale të dërguara për gjykim.

Procedime të regjistruara janë procedimet që kanë filluar të hetohen në vitin korrent. Procedime të pushuara janë procedimet për të cilat prokurori në përfundim të hetimeve paraprake vendos vetë ose i kërkon gjykatës pushimin e çështjes ose akuzës, kur janë rastet e parashikuara nga neni 328 i Kodit të Procedurës Penale. Procedime të pezulluara janë vendimmarrjet e prokurorit në rastet kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm. Statistikat mbi procedimet penale për gjykim paraqesin numrin e çështjeve të dërguara në gjykatë për gjykim të një personi të akuzuar ose që do të akuzohet për kryerjen e një vepre penale.



## 5. Të pandehur

Statistikat për të pandehurit paraqesin të dhëna për numrin e të pandehurve të rinj që u nënshtrohen procedimeve penale për gjykim gjatë vitit referues. Në sistemin e drejtësisë, në këtë fazë ata nuk janë më persona të dyshuar në kryerjen e një vepre penale, siç ishin në polici por janë persona të akuzuar. Për qëllime statistikore, në totalin e të pandehurve janë shtuar të dhëna edhe për personat nën hetim.

## 6. Të burgosur

Të dhënat për personat në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale i referohen numrit gjithsej të personave të dënuar me burg dhe të paraburgosur, në burgje, qendrat e paraburgimit, institucionet e burgosjes së të miturve si edhe spitale të burgut, deri në dhjetor të çdo viti. Të dënuar me burg i referohet personave që ndodhen në burgje, të cilët kanë marrë dënimin përfundimtar me burgim. Të paraburgosur i referohet personave që janë në qendrat e paraburgimit dhe në burgje, ndaj të cilëve është marrë masë sigurimi “arrest në burg”.

### Përkufizime

**Vrasje me dashje:** Vepër e kundraligjshme, me anë të së cilës i hiqet jeta një personi tjetër me dashje. Përfshihen veprat penale si: Neni 76 Vrasje me dashje, Neni 77 Vrasje me dashje në lidhje me një krim tjetër, Neni 78 Vrasje me paramendim, Neni 78/a Vrasje për gjakmarrje, Neni 79 Vrasje në rrethana cilësuese, Neni 79/a Vrasje e funksionarëve publik, Neni 79/b Vrasja e punonjësve të policisë së shtetit, Neni 79/c Vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare, Neni 81 Vrasje e foshnjës.

**Krime seksuale:** Përfshihen nenet 100-108/a të Kodit Penal.

**Vjedhje me dhunë:** Përfshihet neni 139 i Kodit Penal.

**Krime me dashje kundër shëndetit:** Përfshihen nenet 86-90 të Kodit Penal.

**Mashtrike:** Përfshihen nenet 143-149/b të Kodit Penal.

**Fallsifikim monedhash:** Përfshihet neni 183 i Kodit Penal.

**Krime në fushën e drogës:** Përfshihen veprat penale si: Neni 283 Prodhimi dhe shitja e narkotikëve, Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve, Neni 284 Kultivimi i bimëve narkotike, Neni 284/c Prodhimi dhe fabrikimi i lëndëve narkotike dhe psikotrope.

**Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor:** Përfshihen veprat penale si: Neni 290 Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, Neni 291 Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor në gjendje të dehur, pa dëshmi, Neni 273 Largim nga vendi i aksidentit.